



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 28 paragrafi 2 pika (l) lidhur me nenin 29 paragrafi 2 pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, e konform nenit 12, pika 2 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, e në zbatim të kërkesës së Ministrisë të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, me numër të protokollit Nr. 6594-2/25 të datës 07.10.2025, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, ----- miratoi këtë:

Projekt- V E N D I M
Për shfuqizimin e Rregullores 01-Nr-016-56044

Neni 1

Me këtë vendim shfuqizohet Rregullorja për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës me numër të protokollit 01-Nr-016-56044, e datës 29.08.2025.

Neni 2

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI